



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

PROJEKT-VENDIM

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FATKEQËSINË E RËNIES SË ZJARRIT NË DATËN 06.12.2024 NËBANESËN E Z. NAXHI MUÇAJ , LAGJA “ HASAN SEITAJ ” ÇOROVODË NJ. A. ÇOROVODË, BASHKIA SKRAPAR .

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019 , “ Për mbrojtjen civile”, VKM nr. 329 datë 16.05.2012, “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.86 datë 21.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit të vitit 2025, të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj”, Kryetari i Bashkisë:

PROPOZON :

- 1- Të akordojë ndihmën financiare prej 250.000 (dyqind e pesë dhjetë mijë) lekë, familjes së z. Naxhi Muçaj për dëmet e shkaktuara nga zjarri i rënë , në banesën e tij, më datën 06.12.2024 në lagjen “ Hasan Seitaj ” Çorovodë, Njësia Administrative Çorovodë, Bashkia Skrapar .
- 2- Efektet financiare do të përballohen nga fondi i emergjencave civile, parashikuar në buxhetin e vitit 2025 të Bashkisë Skrapar.

**KRYETARI I BASHKISË
ADRIATIK MEMA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR

RELACION
PËR PROJEKT VENDIMIN

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FATKEQËSINË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESËN E Z. NAXHI MUÇAJ , LAGJA " HASAN SEITAJ " ÇOROVODË, NJËSIA ADMINISTRATIVE ÇOROVODË, BASHKIA SKRAPAR .

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak Skrapar,

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", VKM nr. 329 datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, me propozim edhe të Kryetarit të Bashkisë, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak :

- Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare nga fondi i Emergjencave Civile , në masën 250.000(dyqind e pesë dhjetë mijë) lekë sipas preventivit të vlerësimit të banesës së djegur nga zjarri i datës 06.12.2024. Shpërblimi financiar është i pjesshëm .

Sipas raportit të ndërhyrjes nga sektori i M.Z.SH Skrapar, objekti shtëpi banimi, banesë 2 (dy) kateshe me hapësirë 2 + 1 Lagja " Hasan Seitaj " Çorovodë , është përfshirë nga flakët në mënyrë të papritur, rreth orës 15:18' të datës 06.12.2024 .

Sipas proces-verbalit të mbajtur më datën 23.12.2024 në banesën e z .Naxhi Muça, Lagja " Hasan Seitaj " Çorovodë Njësia Administrative Çorovodë , Grupi i punës ka konstatuar dëme të mëdha dhe një djegje totale të banesës, të cilat janë të detajuara në proces-verbalin e sipërpërmendur .

Familja e Z. Naxhi Muça ka nevojë për ndihmë financiare për ristrukturimin e shtëpisë . Sepse ndërtesa (banesa) në gjendjen e krijuar pas rënies së zjarrit, është bërë pjesërisht e pa banueshme .

**KRYETARI I BASHKISË
ADRIATIK MEMA**

